



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Ligji Nr. 04/L-181**

**PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë ligj përcaktohen kërkesat teknike dhe vlerësimi i konformitetit për përdorimin e produkteve ndërtimore, si kusht për vendosje në treg, distribuim dhe shfrytëzim nëse i plotësojnë kërkesat themelore për punët e ndërtimit, zbatimi i procedurave administrative, të drejtat dhe detyrimet e organeve të administratës shtetërore, personave juridik dhe atyre fizik.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet për produktet e ndërtimit të cilat i plotësojnë kërkesat themelore për objektet e ndërtimit të përcaktuara me nenin 4. të këtij ligji.
2. Vendosja në treg, distribuimi dhe përdorimi i produkteve ndërtimore nuk mund të kufizohet nëse i plotësojnë kërkesat e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet e miratuara në bazë të këtij ligji.

**Neni 3**

## Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** – Ministria përkatëse e Tregtisë dhe Industrisë;

1.2. **Produkt i ndërtimit** - çdo produkt i cili është prodhuar dhe vendosur në treg për përdorim të përhershëm në punimet e ndërtimit ose pjesë të tyre;

1.3. **Punime ndërtimore**- ndërtimet e objekteve dhe punët e ndërtimit të ulët dhe të lartë;

1.4. **Karakteristika themelore**- ato karakteristika të produktit të ndërtimit të cilat kanë të bëjnë me kërkesat themelore për punët e ndërtimit;

1.5. **Konformiteti i një produkti ndërtimor** - performancën e cila ka të bëjë me karakteristikat themelore relevante, të shprehura me nivel ose klasë apo me një përshkrim;

1.6. **Specifikim i harmonizuar teknik** - standardet në të cilat referohen rregullat teknike, rregullat teknike dhe miratimet teknike;

1.7. **Specifikim teknik i miratuar**- standardet kosovare ose miratimet teknike të Kosovës të cilat Komisioni i Komitetit Evropian i pranon të tilla përkatësisht pranon se produktet e prodhuara që janë në përputhje mundësojnë plotësimin e kërkesave themelore për punët e ndërtimit;

1.8. **Miratimi teknik**- vlerësimi teknik i përshtatshmërisë së produktit ndërtimor për qëllim të caktuar i cili bazohet në përmbushjen e kërkesave themelore për ndërtimin për të cilën shfrytëzohet produkti;

1.9. **Vendosja në dispozicion të tregut** - çdo furnizim me një produkt të ndërtimit të destinuar për shpërndarje apo përdorim në tregun e Republikës së Kosovës në rrjedhën e një veprimtarie tregtare, qoftë me apo pa pagesë;

1.10. **Vendosja në treg**- vënia në dispozicion të një produkti të ndërtimit në tregun e Republikës së Kosovës;

1.11. **Operator ekonomik**- prodhuesi, distributori, përfaqësuesi i autorizuar apo importuesi;

1.12. **Prodhues**- çdo person fizik apo juridik i cili prodhon një produkt ndërtimi ose e dizajnon apo prodhon një produkt dhe e vendos në treg atë produkt me emrin apo markën tregtare të tij;

1.13. **Distributor**- çdo person fizik apo juridik në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit, i cili e vendos në dispozicion të tregut një produkt ndërtimi;

1.14. **Importues**- çdo person fizik apo juridik, i cili e importon dhe vendos një produkt të ndërtimit në tregun e Republikës së Kosovës;

1.15. **Përfaqësues i autorizuar** - çdo person fizik apo juridik i autorizuar me shkrim nga një prodhues për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyra të specifikuar;

1.16. **Tërheqje e produktit** - çdo masë e cila ka për qëllim parandalimin e një produkti të ndërtimit në zinxhirin e furnizimit, që të jetë në dispozicion të tregut;

1.17. **Rikthimi i produktit** - çdo masë e cila ka për qëllim kthimin e një produkti të ndërtimit i cili tashmë është vënë në dispozicion për shfrytëzuesin e fundit;

1.18. **Kontrolli i prodhimit në fabrikë**- kontrolli i dokumentuar, i përhershëm dhe i brendshëm i prodhimit në një fabrikë në përputhje me specifikimet e harmonizuara teknike përkatëse;

1.19. **Cikli i përdorimit**- faza të njëpasnjëshme dhe të ndërlidhura të përdorimit të një produkti të ndërtimit, nga përvetësimi i lëndës së parë apo prodhimi nga burimet natyrore deri në depozitimin përfundimtar;

1.20. **Organi i autorizuar për vlerësim të konformitetit** - Organi për vlerësim të konformitetit që kryen punët e vlerësimit të konformitetit në bazë të vendimit për autorizim të cilin e miraton ministria;

1.21. **Rregullore për punët e ndërtimit** – akt nënligjor i cili nxjerrët nga Ministria përkatëse për ndërtim me të cilin përcakton në mënyrë detale kërkesat themelore për punimet e ndërtimit;

1.22. **EOTA** - Organizata Evropiane për Miratime Teknike;

#### **Neni 4** **Kërkesat themelore**

1. Kërkesat themelore për punimet e ndërtimit të cilat përcaktohen me Rregullore për punët e ndërtimit, duhet të plotësohen duke pasur parasysh karakteristikat kryesore të produkteve si më poshtë:

1.1. rezistenca mekanike dhe qëndrueshmëria;

1.2. siguria në rast zjarri;

1.3. higjiena, shëndeti dhe mjedisi;

1.4. siguria në përdorim;

1.5. mbrojtja nga zhurma;

1.6. eficientia e energjisë dhe ruajtja e nxehtësisë;

1.7. shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

2. Ministria me akt nënligjor përcakton karakteristikat e produkteve të ndërtimit në pajtim me kërkesat themelore.

3. Për procedurat lidhur me vendosjen në treg dhe distribuimin e produkteve ndërtimore të cilat nuk janë të rregulluar me këtë ligj, zbatohen dispozitat e akteve të veçanta me të cilat rregullohet siguria e përgjithshme e produkteve, kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësimi i konformitetit.

#### **Neni 5**

##### **Karakteristikat teknike të produktit ndërtimor**

1. Karakteristikat teknike të produktit ndërtimor duhet të jenë të tilla që me përshkrimin e përcaktuar në përputhje me qëllimin e dhënë të ndërtimit, ose me projektin për mirëmbajtjen specifike ti përballojnë të gjitha ndikimet e përdorimit të zakonshëm dhe ndikimet e mjedisit, në mënyrë që objekti në të cilin është ndërtuar gjatë afatit kohor të projektit të shfrytëzuar plotëson të gjitha kërkesat themelore për ndërtim.

2. Karakteristikat teknike të cilat duhet t'i posedoj produkti ndërtimor, përcaktohen sipas standardeve të harmonizuara teknike.

#### **Neni 6**

##### **Deklarata e konformitetit**

1. Kur një produkt i ndërtimit është konform standardit ose është në pajtueshmëri me vlerësimin teknik, prodhuesi duhet të hartojë deklaratën e konformitetit, kur një produkt i tillë vendoset në treg.

2. Me deklaratën e konformitetit, prodhuesi merr përgjegjësinë për konformitetin e produktit të ndërtimit me performancën e tillë të deklaruar.

#### **Neni 7**

##### **Shmangiet nga hartimi i deklaratës së konformitetit**

1. Prodhuesi mund të shmanget nga hartimi i deklaratës së konformitetit në rastet kur:

1.1. produkti i ndërtimit është prodhuar në mënyrë individuale ose me porosi në një proces jo-serik në përgjigje të një porosie specifike, nga një prodhues i cili është përgjegjës për inkorporimin e sigurt të produktit në punë të ndërtimit dhe nën përgjegjësinë e atyre që janë përgjegjës për ekzekutimin e sigurt të produktit në punë të ndërtimit, konform dispozitave ligjore;

1.2. produkti i ndërtimit është prodhuar në vend punishte për inkorporimin e tij në punët e caktuara të ndërtimit dhe në përgjegjësi të atyre që janë përgjegjës për ekzekutimin e sigurt të punëve të ndërtimit, konform dispozitave ligjore ose;

1.3. produkti i ndërtimit është prodhuar në mënyrë tradicionale ose në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen e trashëgimisë dhe në një proces jo-industrial për mënyrën adekuate të punëve në rinovimin e ndërtimit të mbrojtur zyrtarisht si pjesë e një mjedisi të caktuar apo për shkak të vlerave të tij të veçanta arkitektonike apo historike.

## **Neni 8**

### **Përmbajtja e deklaratës së konformitetit**

1. Deklarata e konformitetit duhet të shpreh performancën e produkteve të ndërtimit në raport me karakteristikat themelore të atyre produkteve në pajtim me specifikimet teknike përkatëse.

2. Deklarata e konformitetit duhet të përmbajë në veçanti të dhënat e mëposhtme:

2.1. referencën e llojit të produktit për të cilin është hartuar deklarata e konformitetit;

2.2. sistemin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së konformitetit së produktit të ndërtimit;

2.3. numrin e referencës dhe datën e lëshimit të standardit ose vlerësimit teknik që është përdorur për vlerësimin e çdo karakteristike themelore;

2.4. kur është e zbatueshme, numri i referencës së dokumentacionit teknik specifik të përdorur dhe kërkesat me të cilat prodhuesi deklaron se produkti është konform tyre.

3. Deklarata e konformitetit, duhet të përmbajë edhe:

3.1. përdorimin e parashikuar për produktin e ndërtimit, në përputhje me specifikimet teknike të aplikueshme;

3.2. listën e kërkesave themelore, të përcaktuara në specifikimet teknike për qëllimin e deklaruar për përdorim;

3.3. performancën e të paktën një prej karakteristikave themelore të produktit të ndërtimit përkatëse për qëllimin e deklaruar për përdorim;

3.4. kur është e zbatueshme, performancën e produktit të ndërtimit sipas niveleve ose klasave, ose në përshkrim nëse është e nevojshme në bazë të llogaritjeve në lidhje me karakteristikat e tij themelore të përcaktuara me këtë ligj;

3.5. performancën e karakteristikave themelore të produktit të ndërtimit të cilat janë të destinuara për përdorim, duke marrë parasysh dispozitat në lidhje me përdorimin e parashikuar aty ku prodhuesi synon të vendos produktin në dispozicion të tregut;

3.6. karakteristikat e shënuara themelore për të cilat nuk kërkohet performancë.

4. Kjo deklaratë e konformitetit duhet të hartohet duke përdorur modelin e përcaktuar me akt nënligjor.

## **Neni 9**

### **Ofrimi i deklaratës së konformitetit**

1. Kopja e deklaratës së konformitetit për secilin produkt i vënë në dispozicion në treg duhet të ofrohet në letër ose formë elektronike. Megjithatë, kur një grup i produktit të njëjtë i është ofruar një përdoruesi të vetëm, ai mund të shoqërohet me një kopje të vetme të deklaratës së konformitetit në formë të letrës ose në formë elektronike.
2. Kopja e shkruar e deklaratës së konformitetit ofrohet me kërkesën e pranuesit.
3. Deklarata e konformitetit duhet të ofrohet në gjuhë zyrtare të shtetit ku produkti është në dispozicion.

## **Neni 10**

### **Parimet e përgjithshme dhe përdorimi i shenjës së konformitetit**

1. Shenja e konformitetit, duhet të vendoset në ato produkte të ndërtimit për të cilat prodhuesi ka hartuar Deklaratën e Konformitetit në përputhje me nenet 6 dhe 7 të këtij ligji.
2. Në qoftë se deklarata e konformitetit nuk është hartuar nga prodhuesi në përputhje me nenet 6 dhe 7 të këtij ligji, atëherë shënja e konformitetit nuk lejohet të vendoset.
3. Me vendosjen e shenjës së konformitetit, prodhuesit marrin përgjegjësi për konformitet të produktit të ndërtimit me performancën e deklaruar, si dhe përputhjen me të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në këtë ligj dhe dispozitat tjera ligjore të cilat e përcaktojnë vendosjen e saj.
4. Për çdo produkt ndërtimi konform standardit të harmonizuar ose për të cilët është lëshuar deklarata e konformitetit, shenja e konformitetit është shenja e vetme që vërteton konformitetin e produktit të ndërtimit me performancën e deklaruar në lidhje me karakteristikat themelore konform standardeve, ose deklaratës së konformitetit.
5. Nuk mund të ndalohej ose të pengohet vendosja në treg apo përdorimi i produkteve të ndërtimit të shënuar me shenjën e konformitetit, kur konformiteti i deklaruar korrespondon me kërkesat për përdorim të tillë në Republikën e Kosovës.
6. Republika e Kosovës duhet të sigurojë se përdorimi i produkteve të ndërtimit të shënuara me shenjën e konformitetit nuk do të pengohet nga rregullat ose kushtet e vendosura nga organet publike apo private që veprojnë si një ndërmarrje publike, apo që veprojnë si organ publik në bazë të një pozite monopoli ose nën mandatin publik, kur konformitetet e deklaruara korrespondojnë me kërkesat për përdorim të tillë.

## **Neni 11**

### **Rregullat dhe kushtet për vendosjen e shenjës së konformitetit**

1. Shenja e konformitetit, duhet të vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të pashlyeshme në produktin e ndërtimit ose në etiketë të bashkangjitur në atë produkt. Kur kjo nuk është e mundur ose nuk garantohehet për shkak të natyrës së produktit, ajo vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese.
2. Shenja e konformitetit duhet të shoqërohet nga dy shifrat e fundit të vitit në të cilin ajo është vendosur për herë të parë, emrin dhe adresën e prodhuesit të regjistruar ose shenjën e identifikimit që lejon identifikim të emrit dhe adresën e prodhuesit me lehtësi dhe pa dykuptimësi, kodin unik të identifikimit të llojit të produktit, numrin e referencës së deklaratës së konformitetit, nivelin apo klasën e konformitetit të deklaruar, referencën për specifikimet teknike të zbatuara, numrin e identifikimit të organit të autorizuar (notifikuar), nëse është e aplikueshme dhe përdorimi i destinuar siç është përcaktuar në specifikimet teknike të zbatuara.
3. Shenja e konformitetit duhet të vendoset para vendosjes së produktit të ndërtimit në treg. Kjo mund të shoqërohet nga ndonjë piktogram ose ndonjë shenjë tjetër të vendosur që në veçanti tregon rrezik ose përdorim të veçantë.

## **Neni 12**

### **Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit**

Pika e kontaktit për produktet e ndërtimit do të themelohet dhe funksionojë në kuadër të njësisë përkatëse të MTI-së, e cila rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria.

## **Neni 13**

### **Detyrimet e prodhuesve**

1. Prodhuesit duhet të hartojnë deklaratën e konformitetit në përputhje me nenet 6 dhe 7 të këtij ligji dhe të vendosin shenjën e konformitetit në përputhje me nenet 10 dhe 11 të këtij ligji.
2. Prodhuesit si bazë për deklaratën e konformitetit hartojnë dokumentacionin teknik që përshkruan të gjitha elementet përkatëse në lidhje me sistemin e kërkuar të vlerësimit dhe verifikimit të konformitetit.
3. Prodhuesit duhet të ruajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën e konformitetit për një periudhë prej dhjetë (10) vjetësh pasi që produkti i ndërtimit të jetë vendosur në treg.
4. Prodhuesit duhet të garantojnë se janë krijuar procedurat për të siguruar që prodhimi serik përmban performancën e deklaruar. Ndryshimet në llojin e produktit si dhe në specifikimet teknike të zbatueshme në mënyrë adekuate do të merren parasysh.
5. Prodhuesit duhet që kur konsiderohet e nevojshme duke marr parasysh sigurimin e saktësisë, besueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe konformitetit të deklaruar të një produkti ndërtimi, të kryejnë testimin e mostrave për produktet e ndërtimit të vendosura në treg, të

hetojnë dhe nëse është e nevojshme, të mbajnë një regjistër të ankesave për produktet jokonforme dhe të mbajnë shpërndarësit të informuar për çdo monitorim të tillë.

6. Prodhuesit duhet të sigurojnë se produktet e tyre të ndërtimit kanë llojin, shenjën ose numrin serik ose ndonjë element tjetër që lejon identifikimin e tyre, apo kur madhësia ose natyra e produktit nuk e lejon atë, të sigurohet se informacionet e kërkuara të jenë të shënuara në ambalazh ose në një dokument që shoqërojnë produktin e ndërtimit.

7. Prodhuesit duhet të shënojnë në produktin e ndërtimit ose kur kjo nuk është e mundur në paketimin e tij ose në dokumentin shoqërues të tij, emrin e tyre, emrin e biznesit të regjistruar apo markën tregtare të tij dhe adresën e kontaktit. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme kontaktuese të prodhuesit

8. Kur prodhuesit e vendosin një produkt ndërtimi në treg, duhet të sigurojnë që produkti është shoqëruar me udhëzimet dhe informacionet për sigurinë të cilat duhet të jenë në gjuhë zyrtare dhe me fjalë të cilat mund të kuptohen lehtë nga përdoruesit.

9. Prodhuesit të cilët e konsiderojnë apo kanë arsye për të besuar (presupozojnë) se një produkt ndërtimi të cilin e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me deklaratën e konformitetit ose nuk është në përputhje me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj, duhet menjëherë të ndërmarrin masa korrigjuese për të sjellë produktin e ndërtimit në përputhje me kërkesat ligjore, ose të tërheqin apo të rikthejnë atë. Kur produkti paraqet rrezik, prodhuesi duhet informojë autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë detaje, në veçanti të mos përputhshmërisë dhe të ndonjë mase korrigjuese.

10. Prodhuesit duhet që me kërkesë të arsyetuar nga autoriteti kompetent i mbikëqyrjes së tregut, të shoqërojnë produktin e ndërtimit me të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar përputhshmërinë e tij me deklaratën e konformitetit dhe kërkesat e tjera të zbatueshme të këtij ligji të cilat duhet të jenë në gjuhë zyrtare. Prodhuesit duhet të bashkëpunojnë me autoritetin kompetent të mbikëqyrjes së tregut në saje të kërkesës, për çfarëdo mase të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga produkti i ndërtimit të cilin e kanë vendosur në treg.

#### **Neni 14** **Përfaqësuesit e autorizuar**

1. Prodhuesi mund të autorizoj me shkrim një person fizik ose juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës, me mandat të caktuar si përfaqësues të autorizuar.

2. Hartimi i dokumentacionit teknik nuk është pjesë e mandatit të përfaqësuesit të autorizuar.

3. Përfaqësuesi i autorizuar duhet të kryej detyrat e përcaktuara me mandat i cili i lejon përfaqësuesit të autorizuar që të kryej të paktën detyrat e mëposhtme:

3.1. të mbaj deklaratën e konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të organeve kompetente të mbikëqyrjes së tregut për afatin kohor të përcaktuar në paragrafin 2. të nenit 13 të këtij ligji;



3.2. tu siguroj organeve kompetente të mbikëqyrjes së tregut, të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar konformitetin e produktit të ndërtimit me deklaratën e konformitetit dhe përputhshmërinë me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj;

3.3. të bashkëpunojnë me organet kompetente të mbikëqyrjes së tregut sipas kërkesës së tyre, për çfarëdo veprim të ndërmarrë me qëllim të eliminimit të rrezikut që paraqesin produktet e ndërtimit të cilat përfshihen në mandatin e përfaqësuesit të autorizuar.

## **Neni 15**

### **Detyrimet e importuesve**

1. Importuesit duhet të vendosin në tregun e Republikës së Kosovës vetëm produkte të ndërtimit të cilat janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Para vendosjes në treg të produktit të ndërtimit, importuesi duhet të siguroj që deklarata e konformitetit është kryer nga prodhuesi. Kur importuesi konsideron ose ka arsye të besojë se produkti i ndërtimit nuk është në përputhje me deklaratën e konformitetit ose nuk është në përputhje me kërkesat e tjera të përcaktuara me këtë ligj, importuesi nuk e lejon të vendoset produkti i ndërtimit në treg deri sa produkti nuk përputhet me deklaratën e konformitetit dhe derisa nuk përputhet me kërkesat e tjera të zbatueshme në pajtim me këtë ligj ose derisa të korrigjohet deklarata e konformitetit. Kur produkti i ndërtimit paraqet rrezik, importuesi duhet të informojë prodhuesin dhe organet kompetente për mbikëqyrjen e tregut.

3. Importuesit në produktin e ndërtimit ose në paketimin e tij ose në dokumentet duhet të shënjojnë, emrin e tyre, emrin e biznesit të regjistruar ose markën tregtare dhe piken e tyre të kontaktit.

4. Kur një produkt ndërtimi vendoset në treg, importuesi duhet të sigurojë që produkti është shoqëruar me udhëzuesit dhe informacionet për sigurinë në gjuhë zyrtare, të cilat mund të kuptohen lehtë nga përdoruesit.

5. Importuesit duhet të sigurojnë që derisa produkti i ndërtimit është nën përgjegjësinë të tij, nuk do të rrezikohet konformiteti i tij me deklaratën e konformitetit dhe me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj gjatë ruajtjes apo kushtet e tyre të transportit.

6. Importuesit duhet që, kur konsiderohet e nevojshme duke marr parasysh sigurimin e saktësisë, besueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe konformitetit të deklaruar të një produkti ndërtimi, të kryejnë testimin e mostrave të produkteve të ndërtimit të vendosura në dispozicion të tregut, të hetojnë, dhe nëse është e nevojshme, të mbajnë një regjistër të ankesave për produktet jokonforme, dhe të mbajnë shpërndarësit e informuar për çdo monitorim.

7. Importuesit të cilët e konsiderojnë apo kanë arsye për të besuar (presupozojnë) se një produkt ndërtimi të cilin e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me deklaratën e konformitetit ose nuk është në përputhje me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj, duhet menjëherë të ndërmarrin masa korrigjuese për të sjellë produktin e ndërtimit në përputhje me kërkesat ligjore, ose nëse është e nevojshme, të tërheqin apo të rikthejnë atë. Kur produkti

paraqet rrezik, importuesi duhet informojë autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë detaje, në veçanti të mos përputhshmërisë dhe të ndonjë mase të marrë korrigjuese.

8. Importuesit duhet që për periudhën e përcaktuar në paragrafin 3. të nenit 13 të këtij ligji, të mbajnë një kopje të deklaratës së konformitetit në dispozicion të autoritetit të mbikëqyrjes së tregut dhe të sigurojnë që dokumentacioni teknik është vënë në dispozicion të këtyre autoriteteve, sipas kërkesës.

9. Importuesit duhet që pas kërkesës të arsyetuar nga organi kompetent i mbikëqyrjes së tregut, ta pajisin atë me të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar përputhshmërinë e produktit të ndërtimit me deklaratën e konformitetit dhe me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj të cilat duhet të jenë në gjuhë zyrtare. Importuesit duhet të bashkëpunojnë me organet kompetente të mbikëqyrjes së tregut në saje të kërkesës për çfarëdo mase të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga produkti i ndërtimit të cilin ata e kanë vendosur në treg.

## **Neni 16**

### **Detyrimet e distributorëve**

1. Kur një produkt i ndërtimit vendoset në dispozicion të tregut, distributorët duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e kërkuara të këtij ligji.

2. Para vendosjes në treg të produktit të ndërtimit, distributorët duhet të sigurojnë që produkti i tillë është i shoqëruar nga dokumentet e kërkuara sipas këtij ligji dhe udhëzuesit me informacionet e sigurisë në gjuhë zyrtare që është lehtë e kuptueshme nga përdoruesit. Distributorët duhet gjithashtu të sigurojnë që prodhuesi dhe importuesi kanë vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1. dhe 5. të nenit 13 dhe paragrafin 3. të nenit 15 të këtij ligji.

3. Kur distributorët konsiderojnë ose kanë arsye të besojnë (presupozojnë) se produkti i ndërtimit nuk është në përputhje me deklaratën e konformitetit ose nuk është në përputhje me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligji, distributorët nuk mund të vendosin produktin e ndërtimit në treg deri sa nuk përputhet me deklaratën e konformitetit dhe me kërkesat e tjera të zbatueshme në pajtim me këtë ligj ose derisa të korrigjohet deklarata e konformitetit. Kur produkti i ndërtimit paraqet rrezik, distributorët duhet të informojnë prodhuesin, importuesin dhe organet kompetente për mbikëqyrjen e tregut.

4. Distributori duhet të sigurojnë që derisa produkti i ndërtimit është nën përgjegjësinë tij, nuk do të rrezikohet konformiteti i tij me deklaratën e konformitetit dhe me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj gjatë ruajtjes apo kushtet e tyre të transportit.

5. Distributorët të cilët e konsiderojnë apo kanë arsye për të besuar (presupozojnë) se një produkt ndërtimi të cilin e kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me deklaratën e konformitetit ose nuk është në përputhje me kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj, duhet menjëherë të ndërmarrin masa korrigjuese për të sjellë produktin e ndërtimit në përputhje, ose nëse është e nevojshme, të tërheqin apo të rikthejnë atë. Kur produkti paraqet rrezik, distributorët duhet informojnë autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë detaje, në veçanti të mos përputhshmërisë dhe të ndonjë mase korrigjuese.

6. Distributorët duhet që pas kërkesës të arsyetuar nga organi kompetent i mbikëqyrjes së tregut, ta pajisin atë me të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të dëshmuar konformitetin e produktit të ndërtimit me deklaratën e konformitetit dhe kërkesat e tjera të zbatueshme në këtë ligj të cilat duhet të jenë në gjuhë zyrtare. Distributorët duhet të bashkëpunojnë me organet kompetente të mbikëqyrjes së tregut në saje të kërkesës për çfarëdo mase të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që vijnë nga produkti i ndërtimit të cilin e kanë vendosur në treg.

### **Neni 17**

#### **Rastet në të cilat detyrimet e prodhuesve zbatohen për importuesit dhe distributorët**

Importuesi apo distributori konsiderohet si prodhues nëse përmbushë detyrimet e prodhuesit në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, kur ai vendos një produkt ndërtimi në treg me emrin apo markën e tij tregtare apo nëse e modifikon produktin e ndërtimit tashmë të vendosur në treg në mënyrë të tillë që mund të ndikohet përputhshmëria me deklaratën e konformitetit.

### **Neni 18**

#### **Identifikimi i operatorëve ekonomik**

1. Për periudhën e përcaktuar në paragrafi 3. të nenit 13 të këtij ligji, operatorët ekonomik duhet që sipas kërkesës, organeve kompetente për mbikëqyrje të tregut t'ju ofrojnë të dhënat për:

1.1. çdo operator ekonomik i cili i ka furnizuar ata me produkte ndërtimi;

1.2. çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me produkte ndërtimi.

### **Neni 19**

#### **Procedurat e vlerësimit të konformitetit**

1. Konformiteti i produktit ndërtimor me specifikimet teknike në procedurën e vlerësimit të konformitetit përcaktohet me zbatimin e një apo më shumë veprimeve:

1.1. testimi fillestar i llojit të produktit ndërtimor që realizohet nga prodhuesi, përkatësisht testimi fillestar i llojit të produktit ndërtimor që realizohet nga organi i autorizuar për vlerësimin e konformitetit;

1.2. testimi i mostrave nga prodhimi në bazë të planit të përcaktuar të testimit nga prodhuesi apo organi i autorizuar për vlerësimin e konformitetit;

1.3. testimi i mostrave të rastit të marruara në vend punishte apo treg nga organi i autorizuar për vlerësimin e konformitetit;

1.4. kontrolli i përhershëm në fabrikë që realizohet nga prodhuesi;

1.5. kontrolli fillestar i fabrikës dhe kontrolli fillestar i prodhimit në fabrikë që realizohet nga organi i autorizuar për vlerësimin e konformitetit; dhe

1.6. kontrolli i vazhdueshëm i vlerësimit të konformitetit në fabrikë që realizohet nga organi i autorizuar për vlerësimin e konformitetit.

## **Neni 20**

### **Vërtetimi i konformitetit**

1. Organi i autorizuar për realizimin e veprimeve për vlerësimin e konformitetit dhe prodhuesi për secilin veprim nga neni 19 i këtij ligji që është realizuar ose do të realizohet, lëshon dokumentin dhe e dorëzon tek organi i autorizuar për lëshimin e certifikatave të performances së produktit ndërtimor, prodhuesit, përfaqësuesit të autorizuar përkatësisht importuesit të cilët janë të detyruar që ta ruajnë.

2. Konformiteti i produktit ndërtimor me specifikimet teknike si dhe sipas nevojës, vlerësimi dhe/ose vlerësimi final i rezultateve të veprimeve për vlerësimin e konformitetit, vërtetohen me dokumentet e vlefshme nga paragrafi 1. i këtij neni.

## **Neni 21**

### **Certifikata e kontrollit të prodhimit në fabrikë**

Në bazë të dokumenteve të vlefshme nga neni 20 i këtij ligji për realizimin e veprimeve nga nënparagrafi 1.5., dhe/ose nënparagrafit 1. 6 të paragrafit 1. të nenit 19 të këtij ligji, organi i autorizuar lëshon certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë.

## **Neni 22**

### **Përgjegjësia e organit të autorizuar për vlerësimin e konformitetit**

1. Organi i autorizuar për zbatimin e veprimeve të vlerësimit të konformitetit për produktin ndërtimor me specifikimet teknike, përkatësisht për lëshimin e certifikatës së kontrollit të prodhimit në fabrikë është përgjegjës për zbatimin e këtyre veprimeve, përkatësisht për lëshimin e certifikatës në përputhje me dispozitat dhe rregullat profesionale në fuqi, si dhe për përmbushjen e vazhdueshme të kushteve të përcaktuara për dhënien e autorizimit.

2. Organi i autorizuar për zbatimin e veprimeve të vlerësimit të konformitetit, përkatësisht për lëshimin e certifikatës së kontrollit të prodhimit në fabrikë është i detyruar të njoftoj Ministrinë kompetente për çdo ndryshim në lidhje me kushtet e dhënies apo revokimit të këtij autorizimi më së voni katërmbëdhjetë (14) ditë nga dita e ndryshimit.

### **Neni 23**

#### **Autorizimi për zbatimin e procedurës për vlerësimin e konformitetit dhe lëshimi i certifikatës së kontrollit të prodhimit në fabrikë**

Autorizimi për zbatimin e procedurave për vlerësimin e konformitetit, përkatësisht për zbatimin e veprime të caktuara që zbatohen në procedurën për llojet të veçanta të produkteve ndërtimore, si dhe për lëshimin e certifikatës së kontrollit të prodhimit në fabrikë lëshohet, vazhdohet dhe revokohet nga Ministria kompetente.

### **Neni 24**

#### **Kushtet për autorizim të organeve për vlerësim të konformitetit**

1. Ministria kompetente me akt nënligjor përcakton:

1.1. kushtet për lëshim, vazhdim dhe revokim të autorizimit për zbatimin e procedurave për vlerësimin e konformitetit, përkatësisht zbatimin e veprimeve të veçanta në atë procedurë, si dhe lëshimi i certifikatës së kontrollit të prodhimit në fabrikë në lidhje me personat, përgatitjen teknike, mënyrën dhe kompleksitetin e kryerjes së këtyre punëve, përgjegjësinë për rezultatet e procedurave të miratimeve teknike, pavarësinë në raport me prodhuesin, përfaqësuesin e autorizuar ose importuesin e produktit ndërtimor, si dhe mjetet me të cilat personi juridik vërteton përmbushjen e kushteve; dhe

1.2. metodat e vlerësimit të rezultateve dhe kushteve tjera të lidhura me procedurat, dokumentet dhe veprimet e vlerësimit të konformitetit.

### **Neni 25**

#### **Dokumentet e konformitetit**

1. Dokumentet e konformitetit të produktit ndërtimor janë:

1.1. raporti i testimit;

1.2. certifikata e konformitetit dhe

1.3. deklaratat e konformitetit .

2. Ministria kompetente me akt nënligjor përcakton formën e dokumenteve të konformitetit sipas paragrafit 1. këtij neni.

### **Neni 26**

#### **Organet që lëshojnë dokumentet e konformitetit**

1. Certifikatën e konformitetit e lëshon organi i autorizuar në bazë të kërkesës së prodhuesit, përfaqësuesi të autorizuar, përkatësisht importuesit të produktit ndërtimor i cili bartë shpenzimet e lëshimit të saj. Deklaratën e konformitetit e lëshon prodhuesi, përkatësisht përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi i produktit ndërtimor.

2. Organi i cili ka lëshuar certifikatën e konformitetit, për produktin ndërtimor i cili plasohet në treg në territorin Republikës së Kosovës është i detyruar në afat prej dhjetë (10) ditëve nga dita e lëshimit të tij/saj. Ministria mban evidencën e dokumenteve të lëshuara për konformitet.

### **Neni 27**

#### **Vërtetimi i konformitetit**

Me certifikatën e konformitetit dhe/ose deklaratën e konformitetit vërtetohet se janë zbatuar, ose janë duke u zbatuar veprimet e përcaktuara për procedurat e vlerësimit të konformitetit, dhe që me ato procedura është vërtetuar konformiteti i produktit ndërtimor me specifikimet përkatëse teknike, si dhe produkti mund të plasohet në treg dhe të përdoret për ndërtim.

### **Neni 28**

#### **Veprimet që i paraprijnë lëshimit të dokumenteve të konformitetit**

1. Certifikata e konformitetit dhe deklarata e konformitetit mund të lëshohen vetëm nëse prodhuesi dhe organi i autorizuar për vlerësimin e konformitetit i kanë zbatuar veprimet nga neni 19 i këtij ligji sipas sistemit të vlerësimit të konformitetit së produktit të veçantë ndërtimor të paraparë me rregulloren nga neni 31 i këtij ligji.

2. Në raste të përcaktuara me rregulloren nga neni 31 i këtij ligji deklarata e konformitetit mund të lëshohet pas zbatimit të veprimeve të përcaktuara edhe nëse paraprakisht është leshur certifikata e konformitetit.

### **Neni 29**

#### **Përgjegjësitë e organit të autorizuar**

1. Organi i autorizuar për lëshimin e certifikatave të konformitetit është përgjegjës për certifikatat në përputhje me dispozitat dhe rregullat profesionale në fuqi, si dhe për përmbushjen e vazhdueshme të kushteve të përcaktuara për lëshimin e këtij autorizimi.

2. Organi i autorizuar për lëshimin e certifikatave të konformitetit është i detyruar të njoftoj Ministrinë kompetente për çdo ndryshim në lidhje me kushtet e dhënies apo revokimit të atij autorizimi më së voni katërbëdhjetë (14) ditë nga dita e ndryshimit.

### **Neni 30**

#### **Autorizimi për lëshimin e certifikatës së konformitetit**

Autorizimi për lëshimin e certifikatës së konformitetit lëshohet, vazhdohet dhe revokohet nga Ministria.

### **Neni 31**

#### **Kushtet për autorizim të organeve për vlerësim konformiteti për lëshimin e certifikatave të konformitetit**

1. Ministria me akt nënligjor përcakton:

1.1. kushtet për lëshim, vazhdim dhe revokim të autorizimit për lëshimin e certifikatave të konformitetit në lidhje me personat, përgatitjen teknike, mënyrën dhe kompleksitetin e kryerjes së këtyre punëve, përgjegjësinë për lëshimin e certifikatave të konformitetit, pavarësinë posaçërisht në raport me prodhuesin, përfaqësuesin e autorizuar ose importuesin e produktit ndërtimor, si dhe për personin juridik i cili zbaton procedurat dhe veprimet e vlerësimit të konformitetit, dhe mjetet me të cilat personi juridik vërteton përmbushjen e atyre kushteve;

1.2. sistemet e vlerësimit të konformitetit për produktet ndërtimore;

1.3. kushtet për lëshimin e dokumenteve të konformitetit;

1.4. përmbajtjen e dokumenteve të konformitetit dhe

1.5. mënyrën e udhëheqjes dhe përmbajtjes së evidencës së dokumenteve të konformitetit.

### **Neni 32**

#### **Detyrimi për hartimin e udhëzuesve teknik dhe shënjimi i produkteve të ndërtimit**

1. Prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar përkatësisht importuesi i produktit ndërtimor duhet që para vendosjes në treg ose përdorimit të produktit ndërtimor të hartoj udhëzimet teknike dhe produktin ta shënjoj me shenjen e konformitetit.

2. Produkti ndërtimor nuk mund të vendoset në treg e as të distribuohet pa udhëzuesin teknik dhe pa shenjen e konformitetit.

3. Udhëzuesit teknik duhet të shoqërojnë çdo produkt ndërtimor i ofruar. Kur dy apo më shumë produkte ndërtimore ofrohen në të njëjtën kohë, udhëzuesit teknik duhet të përcjellin çdo paketim të veçantë. Tek dorëzimi i produktit ndërtimor me më shumë pjesë, udhëzuesit teknik duhet të shoqërojnë çdo furnizim apo dorëzim i veçantë.

4. Për zbatimin e dispozitës nga paragrafi 3. i këtij neni përgjegjës është distributori.

### **Neni 33**

#### **Përgjegjësia për shenjen e konformitetit**

Me shënjin e produktit ndërtimor me shenjen e konformitetit prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar përkatësisht importuesi i produktit ndërtimor merr përgjegjësinë që produkti i shënjuar ka karakteristikat teknike të përcaktuara me specifikimet teknike të përshtatshme, që plotëson të gjitha kushtet e tjera të parapara dhe që janë të vërtetuara në mënyrën e parapare me këtë ligj.

### **Neni 34**

#### **Udhëzuesit teknik**

1. Udhëzuesit teknik duhet të përmbajnë një kopje të deklaratës së konformitetit, të dhënat relevante për ruajtje, transport dhe përdorimin e produkteve ndërtimore dhe duhet të jenë të shkruara në gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të jenë të kuptueshme për distributorin dhe përdoruesin.
2. Në udhëzuesit teknik duhet të ceket afati deri kur produkti ndërtimor lejohet të përdoret, përkatësisht që ai afat nuk është i kufizuar.
3. Me tekstin e shkruar udhëzuesi teknik me qëllim të kuptimit më të lehtë mund të përmbajë vizatime dhe ilustrime.

### **Neni 35**

#### **Shenja e konformitetit**

1. Më shenjen e konformitetit mund të shenjohet vetëm produkti ndërtimor për të cilin është lëshuar deklarata e konformitetit.
2. Produkti ndërtimor për të cilin me deklaratën e konformitetit vërtetohet përputhshmëria me specifikimet e harmonizuara evropiane, shënjohet me shenjen e konformitetit CE.
3. Produkti ndërtimor për të cilin me deklaratën e konformitetit vërtetohet përputhshmëria me specifikimet teknike vendore, shënjohet me shenjen e Konformitetit të Kosovës.

### **Neni 36**

#### **Kuptimi i shenjës së konformitetit**

1. Produkti ndërtimor nuk lejohet të krijoj paqartësi në lidhje me karakteristikat e produktit për formën dhe kuptimin e shenjës së konformitetit.
2. Shënjimet tjera të cilat vendosen në produktin ndërtimor nuk lejohet të pengojnë dukshmërinë dhe lejueshmërinë e shenjës së konformitetit.

### **Neni 37**

#### **Shënjimi i produkteve të ndërtimit**

Mënyra e shënjimit të produkteve ndërtimore, forma dhe përmbajtja e shenjës së konformitetit rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria.

### **Neni 38**

#### **Vlefshmëria e dokumenteve dhe shenjave të lëshuara sipas rregulloreve të shteteve tjera**

1. Dokumenti për vlerësimin e konformitetit i lëshuar nga prodhuesi sipas rregullave të shtetit tjetër pranohet nëse organi i autorizuar për zbatimin e veprimeve përkatëse për vlerësim të



konformitetit, përkatësisht lëshimin e certifikatave të konformitetit të produkteve ndërtimore, sipas këtij ligji, vërteton se është lëshuar në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

2. Dokumenti për vlerësimin e konformitetit sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

### **Neni 39**

#### **Marrëveshjet për pranimin e dokumenteve të konformitetit**

1. Dokumenti për vlerësimin e konformitetit, përkatësisht dokumenti i konformitetit i lëshuar në përputhje me kushtet tjera të përcaktuara ndërmjet tyre është i vlefshëm nëse është konform me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat e detyrojnë Republikën e Kosovës.

2. Dokumenti nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

### **Neni 40**

#### **Mbikëqyrja e tregut**

1. Përbushja e kërkesave të parapara me këtë ligj dhe aktet tjera të nxjerra në baze të tij për produktet e ndërtimit të cilat vendosen në treg, do të kryhet nga inspeksioni i tregut.

2. Kur organet e mbikëqyrjes së tregut vërejnë se produkti i ndërtimit nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, menjëherë urdhërojnë nga operatori përkatës ekonomik që të marrë të gjitha veprimet e duhura korrigjuese për të sjellë produktin në përputhje me këto kërkesa ose urdhërojnë tërheqjen e produktit nga tregu brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor, në përputhje me natyrën e rrezikut, siç mund të përshkruajnë ata.

3. Operatori ekonomik duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e përshtatshme korrigjuese në lidhje me produktet e ndërtimit të cilat i ka vendos në treg.

4. Kur operatori përkatës ekonomik, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, nuk merr masa adekuate korrigjuese, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të marrin të gjitha masat e përkohshme për të ndaluar ose kufizuar vënien në dispozicion të produktit të ndërtimit në treg ose tërheqjen e produktit të ndërtimit nga tregu apo të kthejë atë.

5. Organet e mbikëqyrjes së tregut duhet të tregojnë nëse jokonformiteti është për shkak të:

5.1. dështimit të produktit për të arritur performancën e deklaruar dhe/ose për të përbushur kërkesat në lidhje me plotësimin e kërkesave themelore për punët e ndërtimit të përcaktuara në këtë ligj;

5.2. mangësive në specifikimet teknike ose në dokumentacionin teknik specifik.

#### **Neni 41**

### **Detyrat e organeve të autorizuar, prodhuesit, përfaqësuesi i autorizuar, importuesit dhe distributorit**

Organi i autorizuar, prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi dhe distributori janë të detyruar t'i mundësojnë Ministrisë dhe inspektoriatit kompetent për të shqyrtuar të gjitha hapësirat dhe qasje në të gjitha veprimet dhe dokumentet që lidhen me vlerësimin e konformitetit, verifikimi i përdorshmërisë, vendosjen në treg dhe distribuimin e produkteve të ndërtimit.

#### **Neni 42**

### **Mënjanimi i parregullsive në prodhim, vendosja në treg dhe distribuimi**

1. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori kompetent ka të drejtë dhe detyrim që prodhuesit, përfaqësuesit të autorizuar, importuesit, distributorit të produktit ndërtimor me vendim ta urdhëron mënjanimin e parregullsive që kanë të bëjnë me prodhimin, vendosjen në treg dhe distribuimin e produktit ndërtimor.

2. Inspektori kompetent urdhëron prodhuesin e produktit ndërtimor për mënjanimin e parregullsive gjatë prodhimit, nëse vërteton që prodhuesi nuk zbaton në mënyrë të përcaktuar veprimet e vlerësimit të konformitetit të cilat është i detyruar t'i zbatoj, ose nuk përmbush kushtet e parapara në lidhje me zbatimin e veprimeve të vlerësimit e konformitetit.

3. Për mënjanimin e parregullsive në lidhje me vendosjen në treg, përkatësisht distribuim të produktit ndërtimor inspektori kompetent urdhëron prodhuesin, përfaqësuesin e autorizuar, importuesin, ose distributorin e produktit ndërtimor, nëse vërteton se për produktet ndërtimore nuk zbatohen apo nuk janë duke u zbatuar veprimet e përcaktuara për vlerësimin e konformitetit, apo produkti ndërtimor i vendosur në treg, përkatësisht i distribuim nuk është në pajtim me nenin 44 të këtij ligji.

4. Marrja e vendimit nga paragrafi 1. i këtij neni për mënjanimin e parregullsive të prodhimit nuk pengon përgjegjësin për marrjen e vendimit për mënjanim e parregullsive për vendosje në treg, përkatësisht për distribuim të produktit ndërtimor.

#### **Neni 43**

### **Ndalimi i vendosjes në treg dhe distribuimi i produkteve ndërtimore**

1. Inspektori kompetent është i detyruar që me vendim të ndaloj vendosjen në treg dhe distribuimin e produkteve ndërtimore, nëse konstaton se produkti është:

- 1.1. pa dokumente të konformitetit;
- 1.2. pa udhëzues teknik apo me udhëzues jo të rregullt teknik;
- 1.3. pa shenjen e konformitetit të vendit përkatës apo të origjinës;
- 1.4. i shënuar në mënyrë jo të drejte;

1.5. nuk siguron që karakteristikat teknike, përkatësisht përdorshmëria e produktit ndërtimor gjatë distribuimit mbetet e pandryshueshme.

2. Ndalimi nga paragrafi 1. i këtij neni vlen për çdo model përkatësisht sasi të produktit ndërtimor në tregun e Republikës së Kosovës.

3. Me përjashtim të paragrafit 2. të këtij neni, ndalimi i produkteve ndërtimore për te cilat nuk garantohej që karakteristikat teknike të tyre gjatë distribuimit përkatësisht përdorimit mbeten të pandryshuara, ka të bëjë vetëm me modelin e produktit, përkatësisht sasinë e produktit ndërtimor të përfshirë në mbikëqyrjen inspektuese specifike më të cilën është konstatuar ndryshueshmëria e karakteristikave të produktit ndërtimor.

#### **Neni 44**

##### **Ndalimi i vendosje në treg të produktit ndërtimor**

1. Nëse gjatë procesit të monitorimit nga inspektorati kompetent vërtetohet se produkti ndërtimor nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat e këtij ligji apo me rregullore të veçanta, inspektorati është i detyruar që me vendim të ndalojë vendosjen në treg, distribuimin dhe/ose instalimin, pa marrë parasysh se për këtë produkt janë zbatuar apo zbatohen veprimet për vlerësimin e konformitetit, përkatësisht që për të është lëshuar dokumenti i konformitetit.

2. Me vendim nga paragrafi 1. i këtij neni urdhërohet kthimi i produktit të papërdorur ndërtimor i cili nuk është vendosur në punët e ndërtimit, nëse vërtetohet që produkti nuk është në konformitet dhe rrezikon jetën e njerëzve dhe/apo mjedisin.

#### **Neni 45**

##### **Dyshimi në produktin ndërtimor**

1. Nëse gjatë mbikëqyrjes së produktit ndërtimor dyshohet se produkti ndërtimor nuk i plotëson kushtet e përcaktuara edhe pse për atë produkt janë zbatuar apo zbatohet procedura për vlerësimin e konformitetit, inspektorati kompetent urdhëron verifikimin/testimin e produktit ndërtimor nga organet për vlerësim të konformitetit.

2. Nëse gjatë procedurës së kontrollit të produktit ndërtimor tek prodhuesit, përfaqësuesi i autorizuar, përkatësisht distributori vërtetohet se produkti ndërtimor nuk plotëson kushtet e përcaktuara, inspektori kompetent me vendim urdhëron ndalimin e vendosjes në treg dhe distribuimin e produktit ndërtimor, dhe me vendimin e njëjtë ndalon vendosjen e produktit ndërtimor në punët e ndërtimit.

3. Me vendim nga paragrafi 2. i këtij neni përcaktohen shpenzimet e zbatimit të procedurës verifikimit/testimit dhe bartësi i pagesës së testimit.

#### **Neni 46**

##### **Procedurat e verifikimit**

1. Me procedurën e verifikimit/testimit vërtetohet nëse produkti ndërtimor ka karakteristikat teknike të përcaktuara dhe nëse plotëson edhe kushtet tjera.

2. Procedura e verifikimit zbatohet me testimin e mostrës së produktit ndërtimor apo zbatimit të veprimeve tjera të duhura sipas programit të përcaktuar nga personi i cili zbaton atë procedurë.

3. Ministria me rregullore të veçantë në mënyrë të detajuar përcakton procedurën e kontrollit dhe mënyrën e zbatimit të saj.

#### **Neni 47**

#### **Produktet e ndërtimit të pa verifikuara**

Produkti ndërtimor për të cilën me vendim është ndaluar vendosja në treg, distribuim dhe vendosja në punët e ndërtimit konsiderohet produkt i ndërtimit, përdorimi i të cilit nuk është vërtetuar dhe në çdo rast konkret të vendosjes së tij në punët e ndërtimit merren masat e përcaktuara me ligj të veçantë.

#### **Neni 48**

#### **Kthimi i produktit ndërtimor të pa vendosur në punët e ndërtimit**

1. Me vendim nga paragrafi 2. i nenit 44 të këtij ligji urdhërohet përfaqësuesi i autorizuar, importuesi përkatësisht distributori i produktit ndërtimor të kthejnë produktin ndërtimor të pa vendosur punimet e ndërtimit tek personi i cili ka lëshuar deklaratën e konformitetit të atij produkti.

2. Personi nga paragrafi 1. i këtij neni i cili ka lëshuar deklaratën e konformitetit të produktit ndërtimor për të cilin është urdhëruar kthimi menjëherë duhet të pranojë produktin.

3. Organi inspektues brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh e sekuestron produktin e personit, i cili nuk ka vepruar sipas paragrafit 1. të këtij neni.

4. Produkti ndërtimor për të cilin është urdhëruar kthimi mundet si produkt ndërtimor përsëri të vendose në treg, distribuohet dhe të vendoset në punimet e ndërtimit pasi që të vërtetohet se produkti i tillë është i sigurt.

#### **Neni 49**

#### **Fusha e përgjegjësisë**

Njësia përkatëse në kuadër të Ministrisë është përgjegjëse për hartimin dhe implementimin e rregullatave ligjore e teknike që ka të bëjë me prodhimin, tregtimin dhe futjen në punime ndërtimore të produkteve të ndërtimit me qëllim të plotësimit të kërkesave themelore të objekteve ndërtimore të të gjitha llojeve përfshirë objektet e infrastrukturës rrugore, hekurudhore, aeroportuale, pastaj të objekteve hidroteknike, urave, ujësjellësve, kanalizimeve, objekteve ekonomike, industriale, civile të banimit individual dhe kolektiv.

**Neni 50**  
**Miratimi teknik**

1. Miratimi teknik është një vlerësim teknik i përshtatshmërisë për përdorim të një produkti për një qëllim të paraparë, duke u bazuar në përmbushjen e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit për të cilat ai përdoret.
2. Procedurat e Miratimit teknik rregullohen me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria.

**Neni 51**  
**Dispozitat ndëshkuese**

Shkeljet eventuale të këtij ligji ndëshkohen konform ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut.

**Neni 52**  
**Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ministria për zbatimin e këtij ligji, nxjerrë akte nënligjore brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 53**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-14 për produktet e ndërtimit.

**Neni 54**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-181**  
**13 qershor 2013**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**